



Fletëudhëzues rreth vijimin të kursit të integrimit

për të qytetarët të huaj, të cilët jetojnë një kohë të gjatë në Gjermani, si dhe për qytetarët të Bashkimit Evropian (BE-së) dhe të nënshtetasëve gjermanë, pa njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane

Të dashur bashkëqytetarë,

Nëse ju si një nënshtetas i huaj jetoni prej kohësh në Gjermani, ose nëse Ju jeni një qytetar apo qytetare i/e i Union-it (BE-së), ose nëse ju si nënshtetas gjerman apo gjermane nuk keni njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane, ju mund të parashtroni një kërkesë pranë Zyrës Federale për Migracion dhe Refugjatë, për të marrë pjesë në një kurs integrimi.

Fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë, të cilët ende vijnë shkollën, nuk mund të marrin pjesë në kursin e integrimit.

Çfarë është kursi i integrimit?

Kursi i përgjithshëm i integrimit përbëhet nga një kurs gjuhe prej 600 orë mësimi si dhe një kurs orientimi me 100 orë mësimi. Kursi i gjuhës përbëhet nga seksione të kursit apo leksione mësimore me gjithësej 100 orë mësimi. Kështu që 300 orët e para mësimore quhen kursi baze i gjuhës, ndërsa 300 orët e tjera mësimore pasuese përbëjnë një kurs të avancuar të gjuhës.

Në kursin e gjuhës ju mësoni një fjalor, i cili ju nevojitet për të folur dhe të shkruar në jetën e përditshme. Kjo përfshinë komunikimin me autoritetet gjegjësisht institucionet zyrtare, bisedat me fqinjët dhe kolegët e punës, shkrimin e letrave si dhe plotësimin e formularëve përkatës.

Kursi i orientimit ju informon mbi jetën në Gjermani si dhe ju ndërmjetëson njohuri mbi rendin dhe sistemin juridik, kulturën dhe historinë e re të vendit.

Egzistojnë edhe kurse speciale për integrim, si për shembull për gra, prindër, të rinjë si dhe për personat, të cilët nuk dinë të lexojnë dhe të shkruajnë si duhet. Këto kurse përbëhen gjithësej nga 1000 orë mësimi. Nëse ju mësoni shpejt, atëherë ju mund të merrni pjesë në një kurs intenziv. Ky kurs përbëhet nga 430 orë mësimi.

Se cili kurs dhe cili modul apo leksion mësimi i kursit ju përshtatet juve më së miri për të filluar kursin për ju, kjo përcaktohet parapakisht nga organizatori i kursit përmes një testit (provimit) para fillimit të kursit përkatës.

Pjesëmarrja në testin (provimin) përfundimtar

Testi (provimi) përfundimtar përbëhet nga testi i gjuhës dhe testi i kursit të orientimit. Nëse ju zotëroni njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane në testin gjuhës dhe e kaloni testin për kursin e orientimit, atëherë ju keni përfunduar me sukses kursin e integrimit dhe në këtë rast merrni certifikatën përkatëse që quhet "Zertifikat Integrationskurs" – "certifikata e kursit të integrimit".

Nëse ju nuk e keni kaluar me sukses testin (provimin), atëherë ju do të merrni vetëm një vërtetim/certifikatë të rezultatit të arritur.

Pjesëmarrja në testin (provimin) përfundimtar është pa pagesë (falas).

Përparësit përmes pjesëmarrjes në kursin e integritimit

Të huajt, të cilët vijnë nga një vend që nuk i përket Bashkimit Evropian (BE-së) duhet ti përmbushin disa parakushte të caktuara, nëse ata dëshirojnë ta marrin të drejtën e përhershme (të pakufizuar) të vendqëndrimit në Gjermani. Ndër të tjera, ata duhet të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane, njohuri themelore mbi rendin dhe shoqërinë, si dhe të kushteve dhe mënyrës së jetesës në Gjermani. Me përfundimin e suksesshëm të kursit të integritimit, këto parakushte janë të plotësuar. Përveç kësaj ju do keni keni mundësi shtesë që më shpejt të natyralizohuni (ta merrni shtetësin gjermane).

Për më tepër, njohurit dhe aftësitë e fituara gjermane në kursin e integritimit ju lehtësojnë jetën e përditshme në Gjermani si dhe i rrisin shanset tuaja për tregun e punës.

Pranimi në një kurs të integritimit nga Zyra Federale dhe regjistrimi i kursit pranë organizatorit të kursit

Ju lutemi plotësoni aplikimin për të drejtën e pjesëmarrjes në një kurs integritimi plotësisht dhe në mënyrë të lexueshme. Ju gjithashtu mund t'ju drejtoheni një organizatori të kursit në afërsi të vendbanimit tuaj, i cili do ju ndihmojë për aplikimin përkatës. Dërgoni ju lutem aplikacionin në selinë e zyres rajonale kompetente për vendin tuaj të Zyrës Federale.

Nëse ju e gëzoni të drejtën e pjesëmarrjes në një kurs të integritimit, ju do të merrni konfirmimin me shkrim nga Zyra Federale (lejen për të drejtë pjesëmarrje në kurs). Njëkohësisht ju do të merrni një listë ku janë shënuar ofruesit/organizatorët e kurseve, të cilët ofrojnë/organizojnë kurse integritimi në afërsi të vendbanimit tuaj.

Pranimi juaj në një kurs të integritimit është i vlefshëm për një vit. Në vërtetimin e lëshuar shkruan më poshtë kjo *"E drejta e pjesëmarrjes në kurs është e vlefshme deri ..."* data deri në të cilën ju mund të regjistroheshi për një kurs të integritimit. Prandaj, ju lutem të regjistrohuni sa më parë që të jetë e mundur tek një organizator i kursit, dhe duke parashtruar vërtetimin e pranimit në fjalë!

Organizatori i kursit duhet t'ju njofton përafërsisht mbi kohën e fillimit të një kursi. Kursi nuk duhet të fillojë më vonë se gjashtë javë nga dita e regjistrimit tuaj. Nëse në këtë kohë nuk organizohet ndonjë kurs integritimi, atëherë organizatori i kursit është i detyruar t'ju njoftojë për këtë. Në këtë rast ju keni mundësinë të vendosni vetë, nëse doni të prisni më gjatë, apo të regjistroheshi tek një tjetër organizator kursi. Në këtë rast organizatori i kursit duhet t'ju kthejë detyrimisht vërtetimin (lejen) e pranimit për kurs të integritimit.

Pjesëmarrja e rregullt në kurs

Për të arritur qëllimin e kursit të integritimit ju duhet të merrni pjesë rregullisht në kursin gjegjës. Kjo do të thotë që ju duhet të ndjekin mësimin rregullisht dhe të merrin pjesë në testin përfundimtar. Gjithashtu pjesëmarrja e rregullt në kurs është e rëndësishme për ju, nëse ju dëshironi ti që të merrni kompensimin e shpenzimit të udhëtimit apo të përsëritni më vonë mësimet e kursit të gjuhës. Organizatori i kurseve vërteton pjesëmarrjen tuaj të rregullt të kursit të gjuhës në formë të shkruar, nëse ju e dëshironi një vërtetim të tillë.

Ndryshimi i organizatorit të kursit është në parim i mundur, vetëm pas përfundimit të një seksioni/leksioni-mësimor të kursit.

Kostoja/shpenzimet e kursit të integritimit

Ju duhet ti paguani organizatorit të kursit një tarifë kontributi prej 1.95 euro për çdo orë mësimi. Kjo tarifë (shumë) duhet të paguhet para fillimit të çdo seksioni të kursit prej 100 orëshe mësimi si dhe para fillimit të kursit të orientimit. Nëse mungoni në orën e mësimit, atëherë shuma për orët e humbura të mësimit, nuk ju kthehen mprapa (nuk ju rimbursohet). Nëse ju nuk keni të ardhura financiare, atëherë në këtë rast shumën e kërkuar duhet ta paguaj personi, i cili mban përgjegjësin për shpenzimet e jetës tuaj.

Ju mund të përjashtoheni nga pagesa (shuma) kontribuese nëse përfitonit nga shteti paratë e

papunësisë II (Arbeitslosengeld II) ose merrni ndihmë sociale ose ju veçanërisht keni vështirësi për të paguar atë, për shkak të ardhurave shumë të ulta.

Kërkesën për përjashtimin nga pagesa, ju duhet të bëni me shkrim tek zyra rajonale të Zyrës Federale, e cila është përgjegjëse për ju (shiko listën e adresave).

Dëshmit në lidhje me nevojat tuaj financiare ju lutem dorëzojeni të bashkangjitura me kopjen e vërtetimit përkatës, si p.sh. vërtetimin mbi përfitimet e papunësisë II, ato të ndihmës sociale, të ndihmës për strehim (banesë), skemës së ndihmës financiare për studentët (BAFöG), asistencës financiare për mbështetje të fëmijëve, përfitimet nga ligjet e imigracionit - azilkërkuësve, përjashtimin nga taksat e kujdesit ditor (tarifave për kopshte), lirimi nga taksat për transmetuesit të shërbimit publik televiziv (GEZ), bileta/tiketa locale sociale, ndihmat për fëmijë dhe mirëqenien e të rinjve në përputhje me Kodin Social (SGB VIII) etj).

Ju lutemi, parashtroni kërkesën e juaj sa më parë që të jetë e mundur, mundësisht përpara pjesëmarrjes në kurs.

Rimbursim/ kompenzimi i shpenzimeve

Nëse ju keni marrë pjesë me sukses në testin përfundimtar pas datës të 08.12.2007, atëherë Zyra Federale mund t'ju rikthejë mbrapsht 50% e vlerës së shpenzimeve të paguara. Kjo vlen vetëm nëse nga data e lëshimit të dokumentit të lejitimit të pjesëmarrjes deri në testin përfundimtar, nuk kanë kaluar jo më tepër se dy vite. Për rimbursimin/ kompenzimin e shpenzimeve të paguara duhet të parashtroni një kërkesë pranë Zyrës kompetente rajonale të Zyrës Federale.

Shpenzimet e udhëtimit

Nëse ju keni qenë të liruar nga Zyra Federale nga pagesa, kostoja të kontributit, atëherë ju zakonisht do të merrni një mbështetje financiare për shpenzimet e udhëtimit. Megjithatë, kusht paraprak është gjithmonë që vendi i kursit të jetë më shumë se 3 km larg vendbanimit tuaj. Ju do të kompenzoheni në parim gjithënjë për shpenzimet e udhëtimit vetëm për vendin më të afërt të kursit. Ju lutemi pyetni organizatorin përkatës të kurseve, nëse duhet të parashtroni kërkesën për shpenzimet e udhëtimit pranë zyrës përkatëse të Zyrës Federale Rajonale.

Parimisht shpenzimet e udhëtimit mund të paguhen vetëm nëse pjesëmarrja e kursit është e rregullt.

Përsëritja e kursit të avancuar të gjuhës

Nëse ju nuk keni qenë në gjendje të vërtetoni njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane në testin përkatës të gjuhës, atëherë ju keni mundësin e përsëritjes edhe një herë deri në 300 orë mësimore të kursit të gjuhës, dhe të merrin sërisht pjesë falas (pa pagesë) në testin e gjuhës (kursit). Por, si kusht paraprak këtu kërkohet dëshmia e pjesëmarrjes të rregullt në mësim.

Pjesëmarrja në testin e gjuhës nuk është e nevojshme, nëse ju vijoni një kurs shkrim/leximit (për analfabetët).

Nëse dëshironi të merrni pjesë në orët e përsëritura duhet të parashtroni një kërkesë pranë Zyrës Federale rajonale përkatëse.

Çfarë tjetër duhet të dini

Të gjithë formularët e aplikimit të lartë përmendura në këtë udhëzues mund ti merreni tek organizatori i kursit, si dhe nga zyra e të huajve ose në Zyrën tuaj kompetente rajonale Federale. Gjithashtu, formularët ju mund ti gjeni edhe në faqen e internetit, në adresen: www.bamf.de. Ky udhëzues përmban informacionet më të rëndësishme për pjesëmarrjen tuaj në kursin e integritimit. Detajet më të hollësishme do ti merrni nga organizatori i kurseve.

Veç të tjerash të merrni në konsideratë ofertat e qendrave këshillimore të migrimit si dhe nga ato të shërbimeve rinore për migrim. Këto qendra mund t'ju ndihmojnë në lidhje me aplikimet, ju përgjigjen pyetjeve dhe njëkohësisht kujdesen për problemet tuaja dhe mund të ju ndihmojnë për të gjetur një kurs të përshtatshme të integritimit për ju.

Informacionet në lidhje me vendndodhjes së adresave të qendrave këshillimore të migrimi si dhe të shërbimeve rinore për migrim, që gjenden në afërsinë e vendbanimit tuaj mund t'i gjeni nga Zyra për të huajt, apo nga selitë rajonale të Zyrës Federale ose në internet në adresën: www.bamf.de

Ju lutem, merrni në konsideratë se gjatë kohës së vijimit të kursit për integrim ju nuk jeni të siguruar në sigurimin ligjor për aksidente.